



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan më ____, ____, 2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje godina (Riparime dhe lyerje të objekteve arsimore)”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur– Shërbime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Kodi CPV:
Shërbime lyerjeje 98316000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,792,681 (dhjetëmilion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) **lekë pa t.v.sh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 8 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te prokuruar.

Kriteri **2.2.1** eshte percaktuar duke u bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe referuar nenit 43 pika 2/b, nenit 47 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Duke marre ne konsiderate shërbimin objekt prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e meparshme nga AK kërkohet qe OE ofertues te paraqesin vertetime se disponojne kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” si dhe Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** ose taksat dhe tarifat vendore per vitin **2024** per ato bashki te cilat me vendim te keshillit bashkiak, afati per pagimin e taksave dhe tarifave vendore (kestet e maturuara) eshte pertej dates se zhvillimit te procedures, te percaktuar ne njoftim e kontrates. Pagesa e taksave dhe tarifave vendore duhet te behet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të ketë paguar taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

-Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

-Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 41 pika 3, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmëri për të zbatuar kontratën. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

- **NS-4 A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

-Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar në nenin 77 të LPP nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në nenin nr. 41, pika 4, germa a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Pikat e licensave janë përcaktuar në bazë të zerave të përshkruara në preventivin e projektit.

- *NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)*

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, **përfshirë suvatimin**, patinimin, **bojatisjen** dhe punime të ngjashme me to.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi A (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe për të cili duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune noteriale
- b) Diplomë

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin nr. 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesi teknik duhet të jetë i punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këtë arsye të paraqitet deklarata perkatese nga Administratori i shoqërisë.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit .Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 2 (dy) punonjës teknike ndertimi
- 2 (dy) punonjës suvatues
- 12 (dymbëdhjete) punonjës bojaxhinj
- 2 (dy) punonjës shofere
- 9 (nëntë) punonjës të thjeshtë/ndihmes

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmia/çertifikata/diploma si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Çertifikatat/diplomat/deshmia duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH”, i ndryshuar.

Ndërsa për teknikun e ndërtimit do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Përveç sa më sipër, për punonjësit shofer duhet të paraqiten deshmi të aftësive profesionale / leje drejtimi dhe certifikate të aftësimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe deklarates së mesipërme. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në përcaktimin e profileve konkrete të stafit teknik punonjësve të kualifikuar, si dhe numrit të tyre, AK është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë

13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zerat e punimeve te preventivit, volumet per keto zera dhe të grafikut të punimeve.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

2 (dy) Teknikë Ndertimi	Nje teknik ndertimi është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kerkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes. Numri i kerkuar i pergjigjet afatit, numrit te konsiderueshem dhe shperndarjes gjeografike te objekteve.
12 (dymbëdhjetë) bojaxhinj	Bojaxhiu është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bëjnë stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjta, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave. Numri i kerkuar eshte bazuar në dokumentin (grafikun) e hartuar nga specialisti i fushës ne perputhje me manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve bojaxhinj eshte parashikuar ne te tre muajt (66 dite pune). Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e lyerjes me boje jane 12,575 ore, qe te kthyer ne dite jane 1,572 dite pune ($12,575/8=1,571.8$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 66 dite del qe nr. i punonjesve te kualifikuar bojaxhinj dhe atyre ndihmes duhet te jete rreth 24 persona. ($1,572/66=23.8$). Pra jane llogaritur minimumi 12 punonjes te kualifikuar bojaxhinj dhe 9 punonjes ndihmes. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muajt).
2 (dy) shofere	Perdorimi i kamionçinave. Numri i kerkuar i pergjigjet numrit te mjeteve te kerkuara, afatit, numrit te konsiderueshem dhe shperndarjes gjeografike te objekteve.
2 (dy) suvatues	Suvatuesi është i nevojshëm për realizimin e punimeve te suvatimit sipas zërave të preventivit. Kryejen vendosjen e një ose më shumë shtresave të suvasë në muret e brendshme dhe në tavanet e godinave duke realizuar një sipërfaqe të lëmuar. Numri i kerkuar eshte bazuar në dokumentin (grafikun) e hartuar nga specialisti i fushës ne perputhje me manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve

	<i>për zërat e punimeve në ndërtim</i>” për kohën e punës që duhet për të realizuar cdo ze të punimeve të parashikuara në preventiv. Kështu sipas manualit orët e punës për të perfunduar punimet e suvatimit janë rreth 720 ore, që të kthyer në ditë janë 90 ditë pune ($720/8=90$). Duke llogaritur që sipas grafikut janë parashikuar të perfundojnë në rreth 54 ditë del që nr. i punonjësve duhet të jete rreth 2 persona. ($90/54=1.6$). Pra janë llogaritur minimumi dy punonjës të kualifikuar. Llogaritja e kohës ditore dhe javore të punës janë bërë bazuar në percaktimet e kodit të punës. (koha ditore e punës 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 ditë pune në muaj)
--	--

2.3.6 Nje punësim mesatar për tre muajt e fundit, i të paktën **28** (njetzet e tete) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mesipër do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, grafikun e punime, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra. **Duke e bazuar në keto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numër minimal punonjësish të kualifikuar për cdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjësish të thejshte/ndihmes. Nga ky numër rezultoi se për të perfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një numër prej 28 punonjësish (stafi kryesor teknik + punonjës të kualifikuar + punonjës të thejshte/ndihmes).**

2.3.7 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

- 1 (një) punonjës të çertifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizëm i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar).

Për punonjësin e mesipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet vetëm nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për siguri dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve si dhe punonjesve të kualifikuar për punimet në lartësi. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet:

”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Në nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, ndër të tjera parashikohet:

15.1 Përkufizime

Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë;
- b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi;
- c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij.
- ç) **puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.**

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve/mjeteve	Disponimi	Njësia	Sasia
1	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Pronësi/Qira	copë	2
2	Betoniere	Pronësi/Qira	cope	2
3	Skele tubo fasade	Pronësi/Qira	m2	220

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, certifikata për transport mallrash për llogari të vet (vetem mjetet e transportit), siguracioni i mjetit, dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumentet e mesiperme duhet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e transportit me qira certifikata për transport mallrash duhet të jete për të trete dhe me qira.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar grafiku dhe analizat teknike, bazuar në legjislacionin e fushës, VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike makinerite, mjetet dhe paisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive sa me sipër është bërë referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
----	--------------------	----------------------------	-------

1	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Shumica e materialeve ne kantier do te sillen me kamionçine per arsye se hyrja ne kantier realizohet nepermjet shesheve te shkollave dhe kopshteve. Numri i kërkuar i pergjigjet afatit, grafikut, numrit te konsiderueshem te objekteve (gjithsej 54) dhe shperndarjes gjeografike te objekteve. <i>Sa me siper eshte hartuar edhe dokumenti (grafiku) nga specialisti i fushës ne perputhje me manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.</i>	copë 2
2	Skele tubo fasade	Per punimet sipas preventivit: Skele tubo fasade > 12m	220 m2
3	Betoniere	Prodhim llaci sipas proceseve te ndryshme pjese e preventivit Numri i kërkuar i pergjigjet afatit, grafikut, numrit te konsiderueshem te objekteve (gjithsej 54) dhe shperndarjes gjeografike te objekteve. <i>Sa me siper eshte hartuar edhe dokumenti (grafiku) nga specialisti i fushës ne perputhje me manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.</i>	copë 2

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqesë :

Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i ketij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin

dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë reziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

Kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare të tyre për produktin: Bojë për lysterjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, shoqëruar me SSH/EN ISO 9001:2015, SSH/EN ISO 14001:2015, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të përdoren, raport analizimi për bojë lysterje muri, lëshuar nga inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të akredituara. Në rastin e kontratës me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Duke qenë se 96 % e punimeve janë lysterje me boje të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të garantojnë autoritetin kontraktor që materialet që do të përdoren, në rastin konkret boje për lysterjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinave, për realizimin e punimeve të kontratës do të jenë në përputhje me kërkesat dhe cilësinë e shprehur në specifikimet teknike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë e perberësve të strukturës së Bashkisë Elbasan, që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë elemente të perberësve të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të VKM nr 629 datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”,

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.